



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:193178

Datë: 27.12.2024

Numri i dokumentit: 06663150

**P.nr.71/21**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL**, nga gjyqtari Fatmir Krasniqi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit **J. S. nga fshati..., Komuna e Dragashit, i akuzuar për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.1 nënpar. 1.4 të Kodit Nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm PP.nr.1585-15/21 të dt. 30.08.2021, pas mbajtjes së seancës fillestare publike në praninë e Prokurorit të shtetit Usein Veliji si dhe të pandehurit J. S. me datë 26.12.2024 publikisht mori dhe shpalli ndërsa me datë 27.12.2024 përpiloi edhe këtë:**

## AKTGJYKIM

### I akuzuari:

**J. S.**, i lindur me dt..., në fsh..., ku dhe tani jeton, komuna e Dragashit, nga i ati H., e ëma F., e vajzërisë M., ka të kryer shkollën fillore, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, punëtor, goran, shtetas i R. së Austrisë.

## ESHTË FAJTOR

Se me datë 06.08.2021, rreth orës 14:15 minuta në fshatin K. i epërm, saktësisht tek vendi i quajtur “N. D.”, në hytje të fshatit, i pandehuri J. S. si pasojë e një mosmarrëveshje paraprake lidhur me aksidentin e veturave të tyre, në atë mënyrë që i pandehuri J. fillimisht kishte dal nga vetura e tij, ku të dëmtuarit i ishte drejtuar me fjalët se “Ma ke goditur automjetin, eja shikoje në anën e majtë”, aty i pandehuri i kishte thënë se dëmtimet i ke prej ma herët dhe për një moment i afrohet të dëmtuarit H. S., me ç’rast e kap për fyti me dorën e majtë, duke i shkaktuar lëndime trupore dhe atë: gërvishje dhe dërmishje lëkurore të anës së djathtë të regjionit të qafës e që si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore, me dëmtim të përkohshëm për shëndetin, të përshkruara si në akt–ekspertimin mjeko-ligjor të Dr.V. K., të datës 25.08.2021.

**- Me këto veprime ka kryer veprën penale: Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 i Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)**

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 e 72, dhe nenit 185 par. 1 nënpar. 1.4 të KPK-es, e nenit 364 të KPP-es, të akuzuarit i shqipton,

## D Ë N I M M E G J O B Ë

Në shumën prej **300 (treqindë) €**, të cilën shumë të dënimit me gjobë do ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

Në raste të mos pagesës së dënimit me gjobë, as me ekzekutim, i njëjti dënim me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgimi duke e llogaritur për çdo **20 €, 1 (një) ditë burgim, rrespektivisht gjithësejtë 15 ditë burgim.**

I akuzuari krahas dënimit kryesor, duhet ti paguaj edhe shpenzimet e procedurës penale, në emër të shpenzimeve gjyqësore shumë prej 30 €, në emër të shpenzimeve për kompensim të viktimave të krimit shumë prej 20 €, në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari H. (Xh.) S. nga fsh..., për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1030-1/24 të dt. 22.07.2024, kundër të pandehurit J. S. nga fshati..., Komuna e Dragashit, i akuzuar për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nënpar. 1.4 të KP-së.

Ne shqyrtimin fillestar pas leximit të aktakuzës PP.nr. 1585-15/21 të dt. 30.08.2021 nga ana e Prokurorit të Shtetit Usein Veliji, i pandehuri J. S. ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata i njoftoj palën këtu të pandehurin rreth pranimin të fajësisë e që është rrethanë lehtësuese që ndikon në zbutjen e dënimit.

I pandehuri J. S. në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KP-së, i ngarkuar sipas aktakuzës.

Prokurori i shtetit Usein Veliji deklaron: Nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë së të pandehurit, meqë i njëjti me vullnet dhe me vetëdije e ka pranuar veprën penale me të cilën akuzohet, e që paraprakisht edhe nga ana e gjykatës është njoftuar për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, andaj gjykatës i propozoj që pas shqyrtimit të fajësisë dhe provave të bashkangjitura, të pandehurin ta shpalli fajtorë dhe ta dënoj sipas Ligjit penal. Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së sanksionit penal, gjykatës i propozojë të ketë parasysh rrethanat renduese, pesha e veprës penale dhe dëmtimi i shëndetit të të dëmtuarit, ndërsa nga rrethanat lehtësuese pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata në shqyrtim fillestar gjyqësor ka vertetur gjendjen e këtille faktike nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili vullnetarisht e ka pranuar fajësinë për shkak të së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyres zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonje prove e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në teresi ka vertetur se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë, e që pranimi i fajit është bërë në menyrë vullnetare dhe pa kushtezime, duke u mbeshtetur në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qene i njoftuar me të gjitha provat materiale.

Gjykata ka ardhë në perfundim, se pranimi i fajësise nga ana e të akuzuarit është bërë ne pajtim me nenin 242 par.1 e 2 nenpar.2.1, 2.2 2.3 2.4 te KPK-se, dhe faktet qe permban aktakuza, në veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e vepres penale, Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën par. 1.4 të KP-ës, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi denimin me gjobë si të merituar, paraprkasht duke e vertetuar pergjegjesinë e tij penalo-juridike.

Me rastin e caktimit te denimit ndaj te akuzuarit, gjykata vleresoi të gjitha rrethanat në kuptim te nenit 69 te KPK-se te cilat ndikojne në caktimin e llojit dhe lartësisë së denimit, duke mos e gjetur rrethanat posaqerisht rënduese e si rrethane lehtesuese është marre pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, pranimi është bërë vullnetshëm, pa presion e as ndikim apo kushtezim nga jashtë, e në kuptim te dispozitave te nenit 70, 71 e 72 i akuzuari ka bashkepunuar me gjykatën, bashkepunimi i tijë ka qene vullnetar në hetimin dhe ndjekjen penale, është hera e parë që ka kryer vepër penale, ka pranuar fajesin vullnetrisht, për veprën e kryer penale, sjellja korrekte, keqëardhja e shprehur gjatë shqyrtimit fillestar, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të këtilla penale, andaj gjykata ia shqiptoi denimin me gjobë të akuzuarit, sepse konsideron se me shqiptimin e denimit do te arrihet qellimi, sepse konsideron se me këtë masë sanksionuese do te arrihet qellimi i denimit, duke menduar se denimi i shqiptuar i pergjigjet shkallës së pergjegjësise se tij dhe me këtë denim do te arrihet qellimi i denimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshem dhe do të permbahet nga veprimet e tilla të karakterit penalo-jurudik.

Vendimi mbi shpenzimet e procedures penale dhe paushallin gjyqesor gjykata e bazoi ne kuptim te nenit 449 par.2 pika 2.1, 2.6 dhe 2.9 te KPPK-së.

Sa i përket obligueshmërisë së pagimit të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, ky vendim u morr konform nenit 36 par. 3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e viktimave të krimit, në fuqi nga data 02.11.2022.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL  
2021:193178, 26.12.2024**

**G j y q t a r i,**

\_\_\_\_\_  
**Fatmir Krasniqi d.v.**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë e nëpërmjet kësaj gjykate.